

Deklaratë për shtyp lëshuar nga Regjistruesi i Gjykatës

GJYKIM I DHOMËS
B CZKOWSKI DHE TË TJERË kundër POLONISË

Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut njoftoi sot me shkrim vendimin e Dhomës së saj në rastin e *B czkowski dhe të Tjerë kundër Polonisë* (ankimi nr. 1543/06).

Gjykata vendosi unanimisht se ka pasur:

- **një shkelje e nenit 11** (liria e organizimit dhe tubimit) të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut;
- **një shkelje e nenit 13** (e drejta për ankim efektiv) të Konventës; dhe
- **një shkelje e nenit 14** (ndalimi i diskriminimit).

Ankuesit nuk ngritën ankim sipas Nenit (thjesht përmbushje detyrimi). (Gjykimi ishte i disponueshëm vetëm në gjuhën angleze.)

1. Faktet kryesore

Ankuesit janë Fondacioni për Barazi (*Fundacja Równości*) dhe pesë anëtarët e tij, përkatësisht Tomasz B czkowski, Robert Biedro , Krzysztof Kliszczyski, Inga Kostrzewa dhe Tomasz Szypuła, gjithashtu anëtarë të organizatave jo qeveritare të cilët bëjnë fushatë në emër të personave të orientimit homoseksual.

Në kontekstin e një fushate të quajtur Ditë Barazie organizuar në datat 10-12 qershor 2005 nga Fondacioni, ankuesit dëshironin të organizonin një marshim i cili do të zhvillohej në rrugët e Varshavës. Marshimi synonte sjelljen në vëmendjen e publikut të diskriminimit ndaj minoriteteve, grave dhe personave me aftësi të kufizuara. Ankuesit gjithashtu kishin për qëllim të mbanin tubime më 12 qershor në shtatë sheshe të ndryshme në Varshavë disa prej të cilave ishin të destinuara për të protestuar në lidhje me diskriminimin ndaj pakicave të ndryshme dhe të tjerët në lidhje me diskriminimin ndaj grave.

Ankuesit paraqitën kërkesën e tyre për leje për të organizuar marshimin më 12 maj 2005 dhe tubimet më 3 qershor 2005.

Më 20 maj 2005, "Gazeta Wyborcza", një gazetë kombëtare, botoi një intervistë me kryetarin e komunës së Varshavës i cili, në përgjigje ndaj pyetjeve në lidhje me kërkesën në pritje të ankuesve për të mbajtur një demonstratë, theksoi se ai do ta ndalonte atë në të gjitha rrethanat dhe se , sipas tij, "propaganda për homoseksualitetin nuk është e barasvlershme me ushtrimin e lirisë së tubimit të dikujt".

Sipas Neneve 43 dhe 44 të Konventës, ky gjykim i Dhomës nuk është i formës së prerë. Gjatë periudhës tre mujore pas dhënies së tij, çdo palë mund të kërkojë që çështja t'i kalojë Dhomës së Madhe të Gjykatës. Nëse bëhet një kërkesë e tillë, një trup prej pesë gjyqtarësh shqyrton nëse çështja meriton shqyrtim të mëtejshëm. Në këtë rast, Dhoma e Madhe do të dëgjojë rastin dhe do të japë një gjykim përfundimtar. Nëse kërkesa për referim refuzohet, gjykimi i Dhomës do të jepet në formë të prerë pas skadimit të një afati tre-mujor ose më parë nëse palët deklarojnë se nuk synojnë të bëjnë kërkesë për referim.

Më 3 qershor 2005, një përfaqësues i Kryetarit të Bashkisë së Varshavës refuzoi lejen e marshimit. Arsyeja për këtë vendim bazohej në pamundësinë e organizatorëve për të paraqitur një "plan të organizimit të trafikut", në përputhje me nenin 65 (a) të Aktit të Trafikut Rrugor. Ankuesit pretenduan se atyre kurrë nuk iu ishte kërkuar të paraqisnin një dokument të tillë.

Më 9 qershor të vitit 2005 Kryetari i Bashkisë dha vendime që ndalonin mitingjet e organizuara nga z B czkowski, z Biedro , z Kliszczy ski, znj Kostrzewa dhe z. Szypuła. Në vendimin e tij Kryetari i Bashkisë u mbështet në argumentin se, sipas dispozitave të Aktit të Tubimeve të vitit 1990, protestat duhej të organizoheshin larg nga rrugët e përdorura për trafik rrugor, duke qenë se kërkesa më të rrepta zbatoheshin në përdorimin e rrugëve për të shmangur rrëmujat. Leja u refuzua edhe mbi bazën se kishte pasur një numër kërkesash të tjera për të organizuar mitingje nga njerëz me ide dhe qëllime të kundërta dhe se ato mund të përfundonin në përleshje midis demonstruesve.

Në të njëjtën ditë iu dha leje protestave në lidhje me diskriminimin e gruas. Leja iu dha edhe demonstratave të tjera me tema të ndryshme si: "Kundër propagandës për partneritete"; "Të krishterët që respektojnë ligjet e Perëndisë dhe ligjet e natyrës janë qytetarë të rangut të parë" dhe "Kundër adoptimit të fëmijëve nga çifte homoseksuale".

Pavarësisht vendimit të datës 3 qershor, marshimi u zhvillua më 11 qershor 2005. Ajo u ndoq nga rreth 3,000 njerëz dhe mbrohej nga policia. Tubimet me leje u mbajtën në të njëjtën ditë.

Më 17 Qershor dhe 22 gusht 2005, autoritetet e apelit anuluan vendimet e datës 3 dhe 9 qershor mbi bazën se ata kishin qenë të justifikuar sic duhet dhe ishin në shkelje të ligjeve në fuqi. Ato vendime të datës 17 qershor dhe 22 gusht 2005 u deklaruan pas datave në të cilat ankuesi kishin planifikuar të mbanin demonstratat. Procedurat, u ndërprejnë.

Më 18 janar 2006 Gjykata Kushtetuese shqyrtoi një kërkesë të paraqitur asaj nga Avokati i Popullit për përcaktimin e pajtueshmërisë me kushtetutën e disa dispozitave të Aktit të Trafikut Rrugor. Ajo dha një vendim në të cilin përcaktohej se dispozitat e Aktit të Trafikut Rrugor sic aplikohen në rastin e ankuesve, ishin në kundërshtim me garancitë kushtetuese të lirisë së tubimit.

2. Procedura dhe përbërja e Gjykatës

Ankimi u paraqit në Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut më 16 dhjetor 2005 dhe u deklarua i pranueshëm më 5 dhjetor 2006.

Gjykimi u dha nga një Dhomë prej shtatë anëtarësh, e përbërë si vijon:

Nicolas **Bratza** (Britanik), *Kryetar*,
Josep **Casadevall** (shtetas i Andorrës),
Stanislav **Pavlovschi** (shtetas i Moldavisë),
Lech **Garlicki** (Polak),
Ljiljana **Mijovi** (shtetas i Bosnjës dhe Herzegovinës),
Ján **Šikuta** (Sllovak),
Päivi **Hirvelä** (Finlandez), *gjyqtarë*,

dhe gjithashtu Lawrence **Early**, *Regjistruer i Seksionit*.

3. Përmbledhje e Gjykimit¹

Ankesat

Ankuesit u ankuan se e drejta e tyre për tubim paqësor ishte shkelur nga mënyra në të cilën autoritetet vendase kishin aplikuar legjislacionin e brendshëm për rastin e tyre. Ata gjithashtu u ankuan se nuk do të kishin në dispozicion të tyre procedura të cilat do ti lejonin ata të merrnin një vendim përfundimtar përpara datës së demonstratave të planifikuara. Ata më tej pohuan se ishin trajtuar në mënyrë diskriminuese duke qenë si iu ishte refuzuar leja për të organizuar demonstrata të caktuara ndërsa organizatorët e tjerë e kishin marrë një leje të tillë. Ata u mbështetën në nenin 11, nenin 13 dhe 14 në lidhje me nenin 11.

Vendimi i Gjykatës

Neni 11

Gjykata përsëriti se i jepte një rëndësi të veçantë pluralizmit, tolerancës dhe largpamësisë. Pluralizmi është ndërtuar edhe në njohjen e vërtetë, dhe respektit për, diversitetin dhe dinamikën e traditave kulturore, identiteteve etnike dhe kulturore, besimeve fetare, ideve artistike, letrare dhe socio-ekonomike dhe koncepteve. Ndërveprimi harmonik i njerëzve dhe grupeve me identitete të ndryshme ishte thelbësor për arritjen e kohezionit social. Ishte e natyrshme që, kur një shoqëri civile funksiononte në mënyrë të shëndetshme, pjesëmarrja e qytetarëve në procesin demokratik, në masë të madhe arrihej përmes përkasisë në shoqata në të cilat ata mund të integrohen me njëri-tjetrin dhe të ndjekin objektiva të përbashkëta në mënyrë kolektive. Detyrimi pozitiv i një shteti për të siguruar respekt të sinqertë dhe efektiv për lirinë e organizimit dhe tubimit ishte me rëndësi të veçantë për ata me pamje të papëlqyeshme apo përkatësi ndaj minoriteteve, duke qenë se ata ishin më të prekshëm ndaj viktimizimit.

Gjykata pranoi se demonstratat ishin mbajtur përfundimisht në datat e planifikuara. Megjithatë, ankuesit kishin ndërmarrë një rrezik përsipër duke patur parasysh ndalimin zyrtar në fuqi në atë kohë. Gjykata vërejti se mund ti kishte dekurajuar ankuesit dhe të tjerët duke mos i lejuar të merrnin pjesë në demonstrata me arsyetimin se, nuk ishte dhënë autorizim zyrtar, dhe as nuk mund të sigurohej mbrojtje zyrtare nga autoritetet kundër demonstruesve potencialisht armiqësorë.

Ajo situatë nuk do të mund të korrigjohet as nga mjetet juridike në dispozicion të ankuesve duke qenë se vendimet relevante ishin dhënë pas datës në të cilën ishin mbajtur demonstratat.

Prandaj, Gjykata konstatoi se kishte pasur një ndërhyrje në të drejtat e ankuesve garantuar sipas Nenit 11. Për më tepër, duke pasur parasysh vendimet e datës 17 qershor dhe 22 gusht ku vendimet e shkallës së parë ishin prishur, ajo ndërhyrja nuk ishte "e përcaktuar me ligj".

Ai konkluzion mund të përforcohet vetëm nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese i datës 18 janar 2006.

Prandaj, Gjykata arriti në përfundimin se ka pasur shkelje të Nenit 11.

Neni 13 në lidhje me Nenin 11

¹ Kjo përmbledhje nga Regjistri nuk është detyruese për Gjykatën.

Gjykata vlerësoi se ishte në natyrën e debatit demokratik që koha e takimeve publike të mbajtura për të shprehur mendime të caktuara mund të jetë vendimtare për peshën e saj politike dhe sociale. Nëse asambleja publike organizohej pas një çështje të dhënë shoqërore, e humbte rëndësinë e saj në një debat aktual shoqëror ose politik, ndikimi i mbledhjes mund të zvogëlohej seriozisht. Liria e tubimit - nëse pengohej të ushtrohej në kohën e duhur - mund edhe të konsiderohej e pakuptimtë. Për këtë arsye, në ato rrethana, nocioni i një mjeti efektiv nënkuptonte mundësinë për të marrë një vendim para kohës së ngjarjeve të planifikuara.

Organizatorët kishin dhënë paralajmërim të mjaftueshëm të planeve të tyre tek autoritetet (12 maj për marshimin dhe 3 qershor 2005 për tubimet): në bazë të nenit 7 të Aktit të Tubimeve në bashki duhet të dorëzohej një kërkesë për mbajtjen e një demonstrate jo më parë se 30 ditë dhe jo më vonë se tri ditë para datës së ngjarjes. Një ligj i ngjashëm nuk ka ekzistuar, megjithatë, autoritetet ishin të detyruara që sipas një afati kohor ligjërish të detyrues të jepnin vendimin e tyre të fundit para kryerjes së demonstrative.

Gjykata nuk u bind se mjetet në dispozicion, të gjitha *post hoc*, mund të kishin ofruar dëmshpërblim të përshtatshëm për ankuesit dhe gjeti se atyre iu ishte mohuar, një mjet efektiv i brendshëm në lidhje me ankimin e tyre. Për këtë arsye ka pasur shkelje të nenit 13 në lidhje me nenin 11.

Neni 14 në lidhje me Nenin 11

Gjykata vuri në dukje se nuk ka pasur diskriminim të hapur prapa vendimeve të shkallës së parë duke qenë se ato përqendroheshin në aspektet teknike të organizimit të demonstratave dhe në përputhjen e tyre me kërkesat e caktuara.

Refuzimi i marshimit bazohej në pamundësinë e ankuesve për të paraqitur një "plan të organizimit të trafikut" ndërsa, Gjykata vërejti, se organizatorë të tjerë nuk kishin qenë subjekt i një kërkesë të ngjashme.

Përsa i përket mitingjeve, ato ishin refuzuar për shkak të, në veçanti, rrezikut të përlëshjeve të dhunshme më 12 qershor ndërmjet demonstruesve. Megjithatë, nuk diskutohet nëse autoritetet iu kishin dhënë leje grupeve të tjera për të mbajtur demonstratat e tyre në të njëjtën ditë.

Gjykata nuk mund të spekulonte për ekzistencën e motiveve të ndryshme përveç atyre të përmendura shprehimisht në vendimet administrative. Megjithatë nuk mund të dilej mbi intervistën e kryetarit të bashkisë të datës 20 maj 2005 në të cilën ai kishte shprehur mendime të forta personale për lirinë e tubimit dhe "propagandën rreth homoseksualitetit" dhe kishte deklaruar se ai do të refuzonte lejen për mbajtjen e demonstratave.

Gjykata përsëriti se kishte pak hapësirë në bazë të nenit 10 për kufizime në fjalimin apo debatin politik. Kjo liri, megjithatë, sa i përket politikanëve të zgjedhur të cilët në të njëjtën kohë mbajnë pozita publike në nivel ekzekutiv qeveritar, kishin përgjegjësi të veçantë. Prandaj ata duhet të tregonin përmbajtje, gjatë ushtrimit të kësaj lirie, sidomos duke pasur parasysh se pikëpamjet e tyre do të mund të konsideroheshin si udhëzime të shërbyesve civilë, punësimi dhe karriera e të cilëve varej në miratimin e tyre.

U vu re se vendimet lidhur me kërkesën e ankuesve për marrjen e lejes për kryerjen e demonstratave ishin dhënë nga autoritetet komunale që vepronin në emër të kryetarit dhe pasi ai kishte bërë të njohur për publikun opinionin e tij për këtë çështje.

Gjykata arriti në përfundimin se ajo mund të pandehte në mënyrë të arsyeshme se opinionet e kryetarit të bashkisë kishin ndikuar në procesin e vendimmarrjes dhe, si rezultat, kishin shkelur në mënyrë diskriminuese të drejtën e ankuesve të lirisë së mbledhjes.

Prandaj, Gjykata ishte e mendimit se kishte pasur shkelje të nenit 14 në lidhje me nenin 11.

Vendimet e Gjykatës mund të gjenden në faqen e saj të internetit (<http://www.echr.coe.int>).

Kontakte Shtypi

Emma Hellyer (telefon: 00 33 (0)3 90 21 42 15)

Stéphanie Klein (telefon: 00 33 (0)3 88 41 21 54)

Beverley Jacobs (telefon: 00 33 (0)3 90 21 54 21)

Tracey Turner-Tretz (telefon : 00 33 (0)3 88 41 35 30)

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut u krijua në Strasburg nga Shtetet Anëtare të Këshillit të Europës në vitin 1959 për trajtimin e shkeljeve të pretenduara të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut të vitit 1950.